



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 183, Datë 06.07.2026

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E
PLOTË TË LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE
SHOQËRIA “EZ5 TRADING” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 17 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/7 prot., datë 03.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 439, Seria F19/F23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 07.03.2019, si dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 288, datë 09.10.2023, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1614 prot., datë 18.05.2026, shoqëria në cilësinë e subjektit mbajtës të licencës ka depozituar aplikimet për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.
- Në mbështetje të kësaj kërkesë dhe pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 28.05.2026, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e licencës së furnizimit të shoqërisë.
- Në zbatim të kërkesave të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.05.2026 dhe 01.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 08.06.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për

paraqitjen e komenteve apo kundërshtimeve nga palët e interesuara nuk u administruan komente apo objeksione lidhur me kërkesën objekt shqyrtimi, çka evidenton mungesën e pretendimeve nga palët e treta mbi procedurën e nisur.

- Në vijim të shqyrtimit të aplikimit, ERE konstatoi nevojën për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe me shkresën nr. 1613/3 prot., datë 11.06.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së transferimit të licencës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.
- Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1613/4 prot., datë 16.06.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 1613/5 prot., datë 24.06.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1613/6 prot., datë 30.06.2026, shoqëria depozitoi informacionin/dokumentacion e kërkuar duke plotësuar dokumentacionin administrativ të nevojshëm për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se kërkesa e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike është paraqitur në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, ku në përputhje me nenin 17, pika 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmeve (a, b, c, d dhe f).
- Në zbatim të nenit 17 të kësaj Rregulloreje, aplikuesi ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për procedurën e transferimit të licencës, ndërsa gjatë shqyrtimit administrativ ka plotësuar edhe dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ERE, duke mundur administrimin e plotë të dosjes së aplikimit.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk rezultojnë mospërputhje me kërkesat e legjislacionit sektorial apo mangësi të tilla që të përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së transferimit të licencës.
- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Po ashtu, në përfundim të procedurës së njoftimit publik të fillimit të procedurës administrative nuk u administruan komente, kundërshtime apo pretendime nga palë të treta, të cilat të

kërkonin verifikime shtesë ose të evidentonin rrethana që do të ndikonin në vlerësimin e kërkesës.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se janë përmbushur kërkesat ligjore dhe procedurale për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.
- Procedura objekt shqyrtimi nuk përbën dhënie të një licence të re, por transferimin e një licence ekzistuese, në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenin 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar. Për rrjedhojë, objekt i shqyrtimit të bordit nuk është rivlerësimi i nevojës për licencimin e kësaj veprimtarie, por verifikimi i përmbushjes së kushteve ligjore për transferimin e cilësisë së mbajtësit të licencës.
- Nga analiza e dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, ndërsa gjatë procedurës administrative ka plotësuar edhe kërkesat e ERE-s për administrimin e dokumentacionit shtesë. Po ashtu, nuk rezultojnë rrethana ligjore ose procedurale që të përbëjnë pengesë për miratimin e transferimit të licencës.
- Bordi konstaton gjithashtu se, gjatë procedurës së njoftimit publik, nuk janë paraqitur komente apo kundërshtime nga palë të treta, ndërsa nga verifikimet e kryera nuk rezultojnë detyrime të papërmbushura ndaj ERE-s që do të ndikonin në përfundimin e procedurës.
- Në vlerësim të dokumentacionit të administruar, bordi çmon se transferimi i licencës nuk sjell ndryshim të objektit, përmbajtjes apo kushteve të licencës së miratuar, por vetëm ndryshimin e subjektit mbajtës të saj. Për rrjedhojë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga licenca nr. 439, Seria F19/F23, vijojnë të ushtrohen dhe të përmbushen nga subjekti përfitues i transferimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e licencës së transferuar.
- Po kështu, bordi vlerëson se miratimi i transferimit të licencës nuk çmon funksionimin normal të tregut të energjisë elektrike, nuk ndikon në ushtrimin e kompetencave rregullatore të ERE-s dhe nuk krijon rrethana që të pengojnë mbikëqyrjen rregullatore të veprimtarisë së licencuar.
- Për sa më sipër, si dhe në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative, bordi çmon se janë plotësuar kushtet ligjore për miratimin e transferimit të licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë transferimin e licencës nr. 439, Seria F19/F23, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “EZ-5 ENERGY ” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-

s nr. 39, datë 07.03.2019, si dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 288, datë 09.10.2023, të shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.

2. Shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të ri të licencës, ushtron veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në përputhje me kushtet e licencës së transferuar, legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuara nga ERE.
3. Transferimi i licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi nuk sjell ndryshim të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në licencën nr. 439, Seria F19/F23, të cilat vijojnë të zbatohen nga subjekti përfitues i transferimit.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY ” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI